



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2168/9 prot.

Datë 16.08.2024

V E N D I M

Nr. 1075/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.08.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Climacasa” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-11470-06-28-2024, me objekt: “Riparim Mirëmbajtje të sistemit Ngrrohje – Ftohje për SUT”, me fond limit 8,122,756.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
Blv. “Dëshmorët e Kombit” Tiranë, Rr “Reshit Collaku”

Ankimues: Operatori ekonomik “Climacasa” SHPK me NIPT L07805502F dhe adresë: Lagjja Beselidhja, Rruga "Shtraus", Pallati Nr. 1, kati perdhe, Lezhë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit

Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik..

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.07.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-11470-06-28-2024, me objekt:“ Riparim Mirëmbajtje të sistemit Ngrohje – Ftohje për SUT”, me fond limit 8,122,756.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 11.07.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor

më datë 24.07.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Climacasa	6,092,068 lekë	Skualifikuar
Sulollari Klima	6,092,068 lekë	Kualifikuar
Altec SHPK	6,092,120 lekë	Skualifikuar
Klima Teknika TB2	7,067,210 lekë	Kualifikuar

II.4. Në datën 31.07.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 31.07.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4393, si dhe nr.2168/2024 prot, datë 31.07.2024 i operatorit ekonomik “Climacasa” SHPK,, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2168/2 prot, datë 01.08.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Climacas” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Me shkresën nr.690/9 prot., datë 06.08.2024, protokolluar me tonën me nr.2168/3 prot., datë 07.08.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Climacasa” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku ndër të tjera argumenton se:

[...] Në datën 31.07.2024, Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet portalit e-Albania pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik me numër protokoll 2168/2024 datë 31.07.2024 dhe Nr aplikimi të ankesës online: A/2024/4393, nga ku rezulton se nuk është paraqitur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur).

II.2. Në nenin 111 "Paraqitja e ankesës" të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës

së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, me anë të e-mailit zyrtar të një prej anëtarëve, në datë 02.08.2024 dërgoi në adresën e e-mailit të deklaruar nga ankimuesi në formularin e ankesës, kërkesën për plotësimin e mangësisë së konstatuar lidhur me dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse përkeshën.

-Plotësimi i mangësive nuk u korrigjua brenda dy ditëve.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimues nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të plotësojë një ankim administrativ.

Për sa më sipër arsyetuar, KSHA gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për paraqitjen e dokumentacionit ligjor të ankimit, ndaj ankesa do të vlerësohet si e paparaqitur.

II.8. Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pagesën e tarifës financiare, KPP iu drejtua me kërkesën nr. 2168/4 prot., datë 08.08.2024, Drejtorisë së Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës, pranë KPP-së, për informacion mbi pagesën e tarifës financiare të kryer nga operatori ekonomik "Climacasa" SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.9. Me shkresën nr. 2168/5 prot., datë 08.08.2024, Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës informon se: "[...] janë kryer verifikime me protokollin, ku rezulton se nuk është kryer pagesë nga operatori ekonomik "Climacasa" SHPK në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar Degës së Thesarit i është kërkuar informacion në lidhje me derdhjet për muajin Korrik-Gusht 2024, nga e cila nuk është dërguar raporti i detajuar".

II.10. Me shkresën nr. 2168/6 prot., datë 16.08.2024, Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës informon se nga korespondenca me Degën e Thesarit lidhur me

derdhjet për muajin Korrik-Gusht 2024 rezulton se nuk është kryer pagesë nga operatori ekonomik “Climacasa” SHPK në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e administruar në datën 31.07.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr 2168/2024 prot., dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4393 e operatorit ekonomik “Climacasa” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-11470-06-28-2024, me objekt: “Riparim Mirëmbajtje të sistemit Ngrohje – Ftohje për SUT”, me fond limit 8,122,756.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, mbi kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të

domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2.Me shkresën nr.690/9 prot., datë 06.08.2024, protokolluar me tonën me nr.2168/3 prot., datë 06.08.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Climacasa” SHPK. Referuar vendimi të KSHA rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku ndër të tjera argumenton se:

[...] Në datën 31.07.2024, Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet portalit e-Albania pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik me numër protokolli 2168/2024 datë 31.07.2024 dhe Nr aplikimi të ankesës online: A/2024/4393, nga ku rezulton se nuk është paraqitur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur).

II.1.2. Në nenin 111 "Paraqitja e ankesës" të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, me anë të e-mailit zyrtar të një prej anëtarëve, në datë 02.08.2024 dërgoi në adresën e e-mailit të deklaruar nga ankimesi në formularin e ankesës, kërkesën për plotësimin e mangësisë së konstatuar lidhur me dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse përkesën.

-Plotësimi i mangësive nuk u korrigjua brenda dy ditëve.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimesi nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së

ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të plotësojë një ankim administrativ.

Për sa më sipër arsyetuar, KSHA gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, nuk ka përmbushur detyrimin për paraqitjen e dokumentacionit ligjor të ankimit, ndaj ankesa do të vlerësohet si e paparaqitur.

III.1.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës nr.2168/3 prot., datë 06.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1738/3 prot., datë 05.07.2024, rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes komunikimit elektronik i ka kërkuar operatorit ekonomik "Climacasa" SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar (më datë 02.08.2024)

operatorin ekonomik ankimues përmes komunikimit elektronik, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Climacasa” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-11470-06-28-2024, me objekt:“ Riparim Mirëmbajtje të sistemit Ngrohje – Ftohje për SUT”, me fond limit 8,122,756.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

